



**REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT**

Zyra e Kryetarit

Nr. 03-24 /2010



**R A P O R T
I PËRKOHSHEM I BUXHETIT JANAR – QERSHOR 2010**

DRENAS, KORRIK 2010

KRF: 1207/090
NO 132

RAPORT I PËRKOHSHEM I BUXHETIT
Janar - Qershor /2010

Kërkesë për raportim

Ligji nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 45,4 kërkon që Kryetari i Komunës të përgatitë dhe t'i dorëzojë Kuvendit Komunal raporte periodike të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të periodës e cila sapo ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohen Kuvendit Komunal dhe më pasë duhet të publikohen në faqën e internetit të komunës për të përmbushur principin e transparencës, lidhur me zhvillimin e Buxhetit Komunal.

Pjesa e mëposhtme përfshinë një përmbledhje të të dhënave fiskale.

Ndarjet Buxhetore

Ligji nr.03/L-177 i paraqet ndarjet buxhetore fillestare 2010. Ky ligj përfshinë edhe mekanizma që mundësojnë ndryshime të këtyre ndarjeve buxhetore gjatë vitit, këto mekanizma përfshijnë:

- * Ndarjen buxhetore të disa llojeve të të hyrave vetanake të mbledhura nga fushat kryesore të të hyrave në vitin paraprak e të pa shpenzuara ;
- * Ndarjen buxhetore nga të hyrat vetanake të planifikuara për arkëtim gjatë vitit 2010 sipas fushave Kryesore të të hyrave dhe sipas sektorëve kryesor ;
- * Ndarjen buxhetore nga grantet nderqeveritare sipas drejtorateve - zyreve komunale, si dhe
- * Ndarjen buxhetore nga grantet e donatorve.

1.Ndarjet buxhetore sipas Ligjit nr.03/L- 177

Nr	Programet	Pag&Mëdit	Mall&Sherb	Sh Komunal	Subvencio	Shp.Kapitale	Totali	Stafi/09
1	Z.Kryetarit	49,365.00	51,468.00	1,000.00	-	-	101,833.00	8
2	D.Administrates	124,224.00	74,670.00	48,100.00	4,700.00	-	251,694.00	44
3	D.Buxh. Financ	49,929.00	8,620.00	360.00	-	-	58,909.00	14
4	D.Bujq.Zhv.Ekon	26,044.00	16,850.00	360.00	-	-	43,254.00	7
5	D.K.R.S.	46,319.00	24,710.00	360.00	21,000.00	-	92,389.00	15
6	D.Pl.Urb.Mjed	35,645.00	13,970.00	360.00	-	1,990,112.00	2,040,087.00	9
7	D.Gjeodezis	36,332.00	7,810.00	360.00	-	-	44,502.00	12
8	D.Inspekcionit	35,204.00	10,090.00	360.00	-	-	45,654.00	10
9	D.Sh.Pub.Emergj	61,271.00	48,445.00	2,790.00	3,000.00	-	115,506.00	20
10	D.Arsimit	3,058,100.00	317,409.00	64,877.00	20,000.00	232,985.00	3,693,371.00	957
11	D.Shendetësisë	630,058.00	192,526.00	40,270.00	26,000.00	11,683.00	900,537.00	200
12	Z.Kuvendit	97,960.00	3,200.00	360.00	-	-	101,520.00	
	Gjithsej:	4,250,451.00	769,768.00	159,557.00	74,700.00	2,234,780.00	7,489,256.00	1,296

Sipas tabelës së lartëshenuar vërehet se buxheti i çertifikuar për vitin 2010, kapë shumën prej: 7,489,256.00 €. Burimet kryesore të financimit janë:

1.Granti nderqeveritar në shumë prej : 6,861,515.00 € apo 91,62%; ku bëjnë pjesë:

Granti i Administratës Komunale në shumë prej: 2,386,903.00 €

Granti i Arsimit në shumë prej : 3,665,371.00 €

Granti i Shendetësisë në shumë prej : 809,241.00 € , si dhe

2.Të hyrat nga burimet vetanake në shumë prej : 627,741.00 €; apo 8,38 % ku bëjnë pjesë:

Të hyrat vetanake, Sektori i Administratës shuma prej : 530,541.00 €,

Të hyrat vetanake, Sektori i Arsimit shuma prej : 28.000,00 € dhe

Të hyrat vetanake, Sektori i Shendetësisë shuma prej : 69.200,00 €.

Zhvillimi dhe analiza e Buxhetit Komunal për periodën Janar - Qershor 2010

Dihet se raporti financiar paraqet një pasqyrë të bilancit të të gjitha të hyrave të arkëtuara - akorduara dhe të dalave - shpenzimeve të realizuara në raport me planifikimin, për këtë të dhënat përmbledhëse për gjashtë mujorin e parë 2010, do të pasqyrohen në tabelën e më poshtme:

2.Skema buxhetore për periodën janar - Qershor 2010

Përshkrimi	Plani për 6 mujorin e parë	Të realizuara	Përqindja ndaj planit
Gjendja Fillestare/010	-	178,827.00	
Të hyrat	4,750,152.00	4,798,878.00	101.03%
Të Dalat	3,126,195.00	2,874,459.46	91.95%
Gjendja me 30.06.010		2,103,245.54	

Të dhënat e prezantuara në tabelën e lartëshenuar, janë të bazuara në raportin e Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës, ku pasqyrohet planifikimi - realizimi i të hyrave dhe të dalave publike për gjashtë mujorin e parë të vitit 2010. Gjendja fillestare prezanton shumën e mjeteve financiare si bartje nga viti paraprak nga të hyrat vetanake të akorduara e të pa shpenzuara për të tre sektoret kryesor.

Sektorit të Përgjithshëm i përketë shuma prej: 151,918.75 €, dhe të gjitha janë rizotu për t'i bërë pagesat lidhur me projektet e parapara me buxhet; ndërsa Sektorit të Arsimit shuma prej: 17,630.49 € dhe Shendetësisë shuma prej: 9,277.48 €, në këta dy sektor mjetet janë rizotu për të paguar projektet që i përkasin kategorisë së shpenzimeve për Mallra dhe Shërbime. Të hyrat janë pasqyruar si të planifikuara dhe realizuara dmth. është prezentuar vetëm akordimi pa arkëtim, për ndryshe përqindja ndaj planit është më e lartë se 101.03 %. Përqindja ndaj planit për të dalat është 91.95 %, dhe pjesa e pa realizuar për 8.05 % është nga mjetet e akorduara na dy burimet e financimit të cilat do të bartën në gjashtëmujorin e dytë të vitit fiskal 2010.

Gjendja me 30.06.2010, është e prezantuar në shumën prej: 2,103,245.54 €, shumë kjo e mjeteve financiare për shpenzime kapitale (1.834,376.47), dhe kategorit tjera të shpenzimeve (268,869.07) e cila është zotuar dhe është në procedurë të prokurimit për projektet kapitale dhe projekte tjera të aprovuara me Buxhetin Komunal. Sipas kësaj vërehet se granti i rregullt për shpenzime kapitale është akorduar sipas planit buxhetor 100%, dhe shpenzimi është planifikuar të jetë i lejueshëm deri në dhjetor 2010.


Me Buxhetin Komunal 2010, është parapa që në Sektorin e Administratës, Arsimit, dhe Shendetësisë të arkëtohen të hyra vetanake. Planifikimin dhe arkëtimin e këtyre të hyrave vetanake për periodën raportuese e paraqet tabela në vijim:

Tabela 3. Të hyrat e burimeve vetanake janar - Qershor 2010.

Nr	Fushat e të hyrave	Planifikimi	Realizimi	Përqindja
1	Lejet-Licencat	43,800.00	46,679.00	106.57
2	Sh.I Tok-lejet e ndërtimit	32,000.00	39,035.23	121.99
3	Aktivitetet gjeodezike	14,500.00	20,538.00	141.64
4	Shërbimet e inspektimit	2,200.00	40.00	1.82
5	Shfrytëzimi i pronës Komunal	9,550.00	4,970.94	52.05
6	Pagesat në lidhje me automjetet	23,150.00	34,123.00	147.40
7	Qertifikatat-dok.zyrtare	26,250.00	41,925.00	159.71
8	Tatimi në pronë	61,500.00	89,598.39	145.69
9	Gjobat në trafik	51,195.00	9,731.00	19.01
10	Të hyrat tjera	1,125.00	1,120.00	99.56
I	Totali i Administratës	265,270.00	287,760.56	108.48
1	Participimi - Qerdhet	10,000.00	16,772.00	167.72
2	Arsimi i mesëm	2,500.00	12,208.00	488.32
3	Të hyrat tjera	1,500.00	-	-
II	Totali i Arsimit	14,000.00	28,980.00	207.00
1	Participimi	20,600.00	45,828.50	222.47
2	Të hyrat tjera	14,000.00	-	-
III	Totali i shendetësisë	34,600.00	45,828.50	132.45
	Gjithsej Totali (I+II+III)	313,870.00	362,569.06	115.52

Tabela e lartëshenuar paraqet planifikimin dhe arkëtimin e të hyrave nga burimet vetanake për periodën janar-qershor dhe vërehet se objektivi është realizuar 115.52 %. Administrata e ka realizuar objektivin 108.48 %, Arsimi objektivin e ka realizuar 207.00 %, ndërsa Shendetësia 132.45 %.

Krahasuar me periodën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rritje për + 4.18%, të hyra të arkëtuara.



- 1.Ngjyra kafe paraqet planifikimin
- 2.Ngjyra e bardh paraqet realizimin

Për t'u bërë ngritja dhe promovimi i ekonomicitetit,efikasitetit dhe efektshmerisë në drejtim të shpenzimit të parave publike,nga sektoret kryesor me kohë është bërë përgatitja e parashikimit paraprak të zotimeve dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2010.Në këtë drejtim ndikim të madh ka pasur aplikimi i metodës së ndarjes buxhetore komunal për njësi më të ulëta buxhetore (drejtorate - zyra komunale).

Dihet se shpërndarja e të dalave me buxhet është parapa sipas ndarjes funksionale dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve,zhvillimin e të cilave e pasqyrojnë tabelat në vijim:

Tabela.4 - Sektori i Administratës
Janar-Qershor/ 010

Nr	Kategorit e shpenzimeve	Planifikimi	Realizimi	Përqindja ndaj planit
1	Paga dhe Mëditje	285,684.00	250,076.57	87.54
2	Mallra dhe Shërbime	153,385.00	133,450.76	87.00
3	Shpenzimet e Shërb.Komunale	27,564.00	24,244.19	87.96
4	Subvencionet	25,400.00	20,618.00	81.17
5	Shpenzimet Kapitale	580,000.00	244,739.41	42.20
	Raporti përmblledhës	1,072,033.00	673,128.93	62.79

Tabela.4.1 - Sektori i Shendetësisë
Janar-Qershor/ 010


Nr	Kategorit e shpenzimeve	Planifikimi	Realizimi	Përqindja ndaj planit
1	Paga dhe Mëditje	300,466.00	399,309.36	132.90
2	Mallra dhe Shërbime	99,616.00	97,756.02	98.13
3	Shpenzimet e Shërb.Komunale	32,142.00	28,873.95	89.83
4	Subvencionet	10,954.50	10,750.00	98.13
5	Shpenzimet Kapitale			
	Raporti përmblledhës	443,178.50	536,689.33	121.10

Tabela.4.2 - Sektori i Arsimit
Janar-Qershor/ 010

Nr	Kategorit e shpenzimeve	Planifikimi	Realizimi	Përqindja ndaj planit
1	Paga dhe Mëditje	1,541,298.00	1,511,240.96	98.05
2	Mallra dhe Shërbime	53,000.00	93,065.43	175.60
3	Shpenzimet e Shërb.Komunale	35,040.00	40,334.81	115.11
4	Subvencionet	-	20,000.00	-
5	Shpenzimet Kapitale	18,000.00	-	-
	Raporti përmblendhës	1,647,338.00	1,644,641.20	99.84

Tabela.4.3 - Buxheti Komunal
Janar-Qershor/ 010

Nr	Kategorit e shpenzimeve	Planifikimi	Realizimi	Përqindja ndaj planit
1	Paga dhe Mëditje	2,127,448.00	2,160,626.89	101.56
2	Mallra dhe Shërbime	306,001.00	324,272.21	105.97
3	Shpenzimet e Shërb.Komunale	97,746.00	93,452.95	95.61
4	Subvencionet	36,354.50	51,368.00	141.30
5	Shpenzimet Kapitale	558,645.50	244,739.41	43.81
	Raporti përmblendhës	3,126,195.00	2,874,459.46	91.95



Tabelat 4.4.1, 4.2 Paraqesin gjendjen e zhvillimit të buxhetit lidhur me të dalat publike sipas sektorve kryesor dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve; ndersa tabela 4.3 paraqet përmblendhjen e të dhenave për zhvillimin e buxhetit komunal sipas kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve.

Nëse bëjmë një krahasim të shpenzimeve me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kemi një zhvillim pozitiv për +14.63%. Edhe pse shpenzimet operative - rrjedhëse kanë një përqindje të mirë në drejtim të realizimit të objektivave, mbetet që në gjashtë mujorin e dytë të vitit fiskal 2010 të jetë një përkushtim më i madh në drejtim të shfrytëzimit të fondeve; ndërsa kategorija ekonomike e shpenzimeve kapitale në gjashtë mujorin e parë shprehur në përqindje është më pakë e zhvilluar, por kjo është rezultat i procedurave të prokurimit dhe mos kryerjes së punimeve në projekte kapitale të cilat bartën në gjashtë mujorin e dytë dhe ç'do herë kjo kategori ekonomike e shpenzimeve shikohet si vit fiskal e jo si periudhë e vitit.

Kryetari i Komunës
Nexhat Demaku

